

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	---	---

Për:	GJEO-PROJEKT SH.P.K, Rr, UÇK-ës, p.n, 21000, Rahovec Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	03.08.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **31.07.2026**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **GJEO-PROJEKT SH.P.K.**, me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-26-4297-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-018-2-2-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **GJEO-PROJEKT SH.P.K.**, me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-26-4297-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-018-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **27.07.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-26-4297-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-018-2-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: **GJEO-PROJEKT SH.P.K.**, me adresë në **Rahovec**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Spërkatje me dronë për kulturat bujqësore – Ritenderim**, me Numër të prokurimit: **623-26-4297-2-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-018-2-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **27.07.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **31.07.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

Baza Ligjore për Refuzim të Kërkesës

Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

ARSYETIM:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si Operator Ekonomik NUK i keni plotësuar kërkesat sipas Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1: Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit, me veprimtari të deklaruar në shërbime bujqësore dhe/ose operime me mjete ajrore pa pilot;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1: Certifikatën e regjistrimit të Biznesit – se bashku me informatat për biznesin, të lëshuar nga Autoritetet e Regjistrimit të Biznesit – Kopje;

Sqarimet janë si në vijim:

Në Dosjen e Tenderit, në kuadër të Kërkesave mbi Përshtatshmërinë Profesionale, është kërkuar si vijon: Kërkesa 1: "Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit, me veprimtari të deklaruar në shërbime bujqësore dhe ose operime me mjete ajrore pa pilot."

Pas shqyrtimit të certifikatës suaj të biznesit, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka konstatuar se: Asnjë prej këtyre aktiviteteve të regjistruara në Veprimtaritë e Certifikatës së Biznesit Tuaj nuk përfshin shërbime bujqësore dhe/ose operime me mjete ajrore pa pilot (dronë), andaj oferta juaj konsiderohet e **papërgjegjshme konform LPP-së;**

Përshtatshmëria profesionale: Kërkesa 1: Operatori Ekonomik do t'i përmbahet në përgjithësi specifikimeve teknike të detyrueshme të paraqitura në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1: Deklaratë me shkrim nga Operatori Ekonomik se do t'i përmbahet në përgjithësi specifikimeve teknike të detyrueshme të paraqitura në Aneksin 1 të Dosjes së Tenderit;

Sqarimet janë si në vijim:

Pas shqyrtimit të plotë dhe të ndërsjellë të dokumentacionit të dorëzuar, Autoriteti Kontraktues konstaton se oferta juaj është e papërgjegjshme, pasi nuk dëshmon përmbushjen e kërkesave thelbësore ligjore, teknike dhe profesionale të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në sqarimet e dhëna gjatë procedurës.

Mangësia kryesore qëndron në faktin se nuk keni paraqitur një konfigurim të plotë dhe të verifikueshëm të operimit, ku të lidhen qartë operatori UAS, piloti i kualifikuar, pajisja konkrete dhe autorizimi i vlefshëm për operim në territorin e Republikës së Kosovës.

Për pilotin Tomislav Korenika janë dorëzuar vetëm certifikatat A1/A3 dhe A2 të kategorisë së hapur, të cilat nuk dëshmojnë kompetencën dhe autorizimin e kërkuar për operimet konkrete me DJI Agras T100 ose HF C30/C50 në kategorinë përkatëse. Për pilotin Mileta Čavorović, dokumenti i paraqitur dëshmon vetëm kalimin e testit nga fusha "Air Law", pa përcaktuar kategori operative, certifikim A4/kategori 4 ose autorizim për operime bujqësore me spërkatje. Për më tepër, dokumentacioni nuk përmban konfirmim, njohje ose autorizim nga AAC e Kosovës për pranueshmërinë e këtyre pilotëve dhe certifikimeve të huaja. Në të njëjtën kohë, dokumentacioni nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme dhe të verifikueshme kapacitetin e integruar teknik të kërkuar për realizimin e kontratës. Redundanca operative është paraqitur pjesërisht, pa identifikim individual dhe status të plotë ligjor të njërive rezervë, ndërsa kapaciteti minimal prej 90 ha/ditë mbështetet në pajisje, personel dhe mjete logjistike që nuk janë dokumentuar në mënyrë të plotë dhe të harmonizuar. Këto kërkesa janë elemente thelbësore të kontratës, për shkak të natyrës sezonale të trajtimit dhe nevojës për vazhdimësi, reagim të shpejtë dhe kapacitet real operativ.

Autoriteti Kontraktues thekson se oferta nuk vlerësohet si e papërgjegjshme për shkak se pajisjet janë të marra me qira ose sepse disa dokumente janë të huaja. Oferta vlerësohet si e papërgjegjshme sepse nuk keni dëshmuar se pajisjet, pilotët dhe operatorët e paraqitur formojnë një kapacitet të ligjshëm, të autorizuar dhe të gatshëm për realizimin e shërbimit në Kosovë, në përputhje me kriteret e përcaktuara paraprakisht.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues konstaton se mangësitë e identifikuara nuk përbëjnë vetëm paqartësi formale, por prekin drejtpërdrejt përshtatshmërinë teknike dhe profesionale të ofertës. Plotësimi i tyre pas afatit të tenderimit përmes marrjes së licencave, autorizimeve, angazhimit të pilotëve ose sigurimit të kapaciteteve të reja do të përbënte ndryshim material të ofertës, andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform LPP-së;

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMET ANKIMORE TË OPERATORIT EKONOMIK

GJEO-PROJEKT SH.P.K, Rr, UÇK-ës, p.n, 21000, Rahovec

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN ANKIMORE NR 1.

Autoriteti Kontraktues, në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë, konkretisht në kuadër të **Përshtatshmërisë profesionale**, ka përcaktuar qartë Kërkesën Nr. 1: *Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit, me veprimtari të deklaruar në shërbime bujqësore dhe ose operime me mjete ajrore pa pilot;*

Objekti i kësaj procedure të prokurimit është **ofrimi i shërbimeve të spërkatjes së kulturave bujqësore me mjete ajrore pa pilot (dronë)**. Për rrjedhojë, operimi me dronë përbën pjesën thelbësore të shërbimit që do të ekzekutohet dhe jo një aktivitet ndihmës apo dytësor.

Nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se Operatori Ekonomik ka të regjistruara aktivitete në fushën e bujqësisë, mirëpo NUK ka dëshmuar se posedon të regjistruar veprimtarinë ekonomike për operimin me mjete ajrore pa pilot.

Pretendimi i Operatorit Ekonomik se kjo veprimtari mbulohet nga kodi **7420 – Aktivitetet e fotografimit** nuk mbështetet me asnjë provë zyrtare. Operatori nuk ka paraqitur:

- asnjë konfirmim nga Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK);
- asnjë interpretim zyrtar të klasifikimit të veprimtarive ekonomike;
- asnjë dokument tjetër që vërteton se kodi 7420 përfshin ofrimin e shërbimeve të spërkatjes bujqësore me dronë.

Përkundrazi, **kodi 7420 lidhet me aktivitetet e fotografimit** dhe nuk dëshmon, në vetvete, se operatori është i regjistruar për kryerjen e shërbimeve të spërkatjes së kulturave bujqësore me mjete ajrore pa pilot, që është objekti konkret i kësaj kontrate.

Autoriteti Kontraktues nuk ka kompetencë të zgjerojë apo të interpretojë përmbajtjen e kodeve të veprimtarisë ekonomike përtej asaj që rezulton nga dokumentacioni zyrtar. Pranimi i një interpretimi të tillë do të nënkuptonte ndryshimin e kriterëve të kualifikimit pas hapjes së ofertave dhe do të ishte në kundërshtim **me parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës** së ndershme, pasi operatorët ekonomikë duhet të vlerësohen vetëm mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar dhe kërkesave të përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Gjithashtu, barra e provës për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit i takon Operatorit Ekonomik. Në mungesë të provave të mjaftueshme dhe të pakontestueshme se posedon regjistrimin për veprimtarinë që lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, Autoriteti Kontraktues nuk mund ta konsiderojë kriterin e përmbushur.

Për rrjedhojë, *pretendimi i Operatorit Ekonomik se kodi 7420 mbulon operimin me mjete ajrore pa pilot* mbetet një pretendim i pambështetur në dokumentacion zyrtar dhe nuk mund të pranohet si provë e përmbushjes së kërkesës së Dosjes së Tenderit.

Prandaj, **pretendimi ankimor lidhur me këtë pikë refuzohet si i pabazuar.**

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN ANKIMORE NR 2.

Në Dosjen e Tenderit, në pjesën "Specifikime Teknike të Detyrueshme" – Kriteret e Përshtatshmërisë Ligjore, është kërkuar qartë që operatori ekonomik të dorëzojë:

Certifikatën valide për regjistrimin e operatorit UAS, të lëshuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës (AAC);

- **Dëshminë për regjistrimin e pajisjes UAS në AAC;**
- **Numrin valid të operatorit UAS.**

Këto kërkesa janë përcaktuar paraprakisht në Dosjen e Tenderit dhe kanë qenë të njëjta për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë.

Operatori Ekonomik pretendon se droni është i regjistruar në Republikën e Kroacisë dhe se, sipas Rregullores së AAC-së Nr. 01/2026, nuk ka obligim për regjistrim në Republikën e Kosovës. Mirëpo, ky argument nuk e ndryshon faktin se në momentin e dorëzimit të ofertës operatori NUK ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar në Dosjen e Tenderit, i cili ishte vendosur si kriter i detyrueshëm për kualifikim.

Edhe nëse dispozitat e Rregullores Nr. 01/2026 lejojnë operimin në kushte të caktuara me një UAS të regjistruar në një shtet tjetër, kjo nuk e përjashton operatorin ekonomik nga detyrimi për të përmbushur kërkesat dokumentare të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Autoriteti Kontraktues nuk mund të heqë dorë nga një kriter i vendosur paraprakisht ose ta zëvendësojë atë me dokumente të tjera që nuk janë kërkuar në Dosjen e Tenderit, pasi një veprim i tillë do të cenonte parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe sigurisë juridike në procedurat e prokurimit publik.

Pretendimi i Operatorit Ekonomik se më vonë ka zhvilluar komunikim me AAC-në dhe ka pranuar interpretim lidhur me zbatimin e Rregullores Nr. 01/2026 nuk mund të merret si bazë për ndryshimin e rezultatit të vlerësimit.

AK-ja sqaron se sipas vetë e-mailit zyrtar të pranuar nga inspektorja e AAC-së (të cilin OE e ka bashkëngjitur), specifikohet qartë: *“Në çdo rast, dispozitat e nenit 8 zbatohen gjithashtu për SAP me regjistrim të huaj”*. Neni 8 kërkon dorëzimin e dokumentacionit të plotë (përfshirë deklaratat e sigurisë, përshkrimin e saktë të operimeve dhe zonave të fluturimit në Kosovë) paraprakisht.

Në momentin e vlerësimit të ofertave, OE nuk ka prezantuar asnjë pëlqim apo aplikim formal të aprovuar nga AAC e Kosovës që i lejon këtij mjeti me regjistrim të huaj të operojë në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës për llogari të këtij projekti. AK-ja nuk mund të mbështetet në premtime për aplikime të ardhshme, por duhet të vlerësojë pjekurinë ligjore të ofertës në momentin e dorëzimit, konform Neni 59 të LPP-së.

Vlerësimi i ofertave bëhet vetëm mbi bazën e dokumenteve të dorëzuara brenda afatit për dorëzimin e ofertave, ndërsa dokumentet ose interpretimet e siguruara pas këtij afati nuk mund të përdoren për të plotësuar ose korrigjuar mungesat në ofertë.

Gjithashtu, korrespondenca e Operatorit Ekonomik me Autoritetin e Aviacionit Civil nuk ndryshon përmbajtjen e Dosjes së Tenderit dhe nuk përbën bazë ligjore që Autoriteti Kontraktues të mos zbatojë kriteret e kualifikimit të përcaktuara paraprakisht. Autoriteti Kontraktues është i detyruar t'i zbatojë kërkesat e Dosjes së Tenderit në mënyrë të njëjtë për të gjithë operatorët ekonomikë dhe nuk mund të bëjë përjashtime gjatë fazës së vlerësimit.

Prandaj, pretendimi ankimor lidhur me këtë pikë refuzohet si i pabazuar.

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN ANKIMORE NR 3.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka vlerësuar ofertën si të papërgjegjshme për faktin se pilotët posedojnë certifikata të lëshuara nga autoritete të huaja, e as nuk ka kontestuar vlefshmërinë e tyre në shtetet ku janë lëshuar. Po ashtu, arsye e eliminimit nuk ka qenë fakti që pajisjet janë marrë me qira apo që dokumentacioni është lëshuar jashtë Republikës së Kosovës.

Arsyeja e eliminimit qëndron në faktin se dokumentacioni i dorëzuar nuk dëshmon në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme përmbushjen e kërkesave të Dosjes së Tenderit, përkatësisht nuk krijon lidhjen e domosdoshme ndërmjet operatorit UAS, pilotit të propozuar, pajisjes konkrete dhe autorizimit përkatës për realizimin e operimeve në territorin e Republikës së Kosovës.

Në veçanti:

- për pilotin **Tomislav Korenika** janë dorëzuar vetëm certifikata të kategorive A1/A3 dhe A2, të cilat nuk dëshmojnë autorizimin e kërkuar për operimet konkrete me pajisjet DJI Agras T100 ose HF C30/C50 në kategorinë përkatëse të kërkuar në Dosjen e Tenderit;
- për pilotin **Mileta Čavorović** është dorëzuar vetëm një dokument që dëshmon kalimin e provimit në fushën "Air Law", pa dëshmuar kategorinë operative, certifikimin A4 apo autorizimin për kryerjen e operimeve bujqësore me dron;

Dokumentacioni i paraqitur nuk përmban asnjë dëshmi që pilotët e propozuar janë të autorizuar ose të njohur për të kryer operimet e kërkuara në territorin e Republikës së Kosovës, në përputhje me kërkesat e Autoritetit të Aviacionit Civil dhe me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Referencat e operatorit ekonomik në faqet zyrtare të autoriteteve të Kroacisë dhe Serbisë nuk përbëjnë provë të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave të tenderit. Barra e provës i takon operatorit ekonomik, i cili duhet të paraqesë dokumentacion të qartë dhe të verifikueshëm që dëshmon se kapaciteti i propozuar është i ligjshëm, i autorizuar dhe funksional për realizimin e kontratës në Republikën e Kosovës.

Për më tepër, edhe kapaciteti teknik i ofertës nuk është dëshmuar në mënyrë të plotë. Kapaciteteve rezervë operative është paraqitur vetëm pjesërisht, pa identifikimin dhe statusin juridik të të gjitha njësive rezervë, ndërsa kapaciteti minimal prej 90 ha/ditë mbështetet në pajisje, personel dhe mjete logjistike të cilat nuk janë dokumentuar në mënyrë të harmonizuar dhe të verifikueshme. Duke pasur parasysh natyrën sezonale të kontratës dhe nevojën për vazhdimësi operative, këto përbëjnë elemente thelbësore të përgjegjshmërisë së ofertës.

Pretendimi për trajtim të pabarabartë është gjithashtu i pabazuar. Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar secilën ofertë vetëm mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar nga operatori përkatës dhe në raport me kërkesat e Dosjes së Tenderit.

Prandaj, **pretendimi ankimor lidhur me këtë pikë refuzohet si i pabazuar.**

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMIN ANKIMORE NR 4.

Pretendimi i Operatorit Ekonomik është i pabazuar

Operatori Ekonomik argumenton se duke ofruar një dron kryesor prej 100L dhe dy dronë rezervë prej 50L (përmes marrëveshjes me "AgroFly d.o.o." nga Serbia), i tejkalon kapacitetet e kërkuara dhe se kapaciteti prej 90 ha i referohet vetëm dronëve 25L.

Ky interpretim teknik i OE-së është i gabuar. DT-ja ka vendosur një prag të prerë teknik: **Kapacitet minimal ditor i garantuar prej 90 ha për realizimin e operimeve**. Ky është një kriter i performancës sasiore ditore (normë pune), pa marrë parasysh vëllimin e rezervuarit të dronit.

Operatori Ekonomik kishte për detyrë të dorëzonte një specifikim të qartë të performancës (ha/orë ose ha/ditë) të vërtetuar nga manualët teknike, që dëshmon se mjetet e ofruara mund ta realizojnë këtë normë në ditë pune. Dorëzimi i thjeshtë i manualeve apo marrëveshjeve, pa specifikuar grafikun dhe përllogaritjen e normës ditore të punës konform specifikimit të DT-së, e bën ofertën të paplotësuar në aspektin e kapacitetit të garantuar ditor.

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>